



STATISTIKA EKONOMIKE PËR TURIZMIN

Raportim
6 MUJORI I PARË 2021

PËRMBAJTJA

HYRJE

1. TË ARDHURAT PËR PERIU DHËN JANAR – QERSHOR 2021


2. INVESTIMET E REJA NË FUSHËN E TURIZMIT

3. SHPENZIMET DITORE DHE NETËQËNDRIMET

Industria e turizmit zë një vend të veçantë në ekonomi dhe është një burim i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Prodhimi i statistikave të harmonizuara me ofertën dhe kërkesën e turizmit, sot konsiderohet si vendimtar për t'u mundësuar vendimmarrësve të vlerësojnë dhe përmirësojnë këtë sektor të rëndësishëm ekonomik. Në këtë buletin statistikor po sjellim të dhëna ekonomike për disa zëra gjatë gjatëmuorit të parë të 2021, që tani janë mundësuar nga Banka e Shqipërisë. Ndërsa të dhënat për Strukturat Akomoduese janë mundësuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatim Taksave.


TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 20210

Bazuar në raportin e bilancit të pagesave të Bankës së Shqipërisë, të dhënat statistikore në udhëtim dhe turizëm gjatë 6-mujorit të parë 2020 (Janar–Qershor) tregojnë që ka rritje prej 68.2% krahasuar me viti 2020, por që ene është një vlerë më e ulët se viti 2019 për shkak të krizës së shkaktuar nga panendemia Covid 19 të dhënat janë si më poshtë:



Grafik 1: Të ardhurat nga udhëtimet/turizmi të 6-mujorit të parë, për vitet 2014 – 2021.
(Burimi: Banka e Shqipërisë)

Edhe të ardhurat neto nga udhëtim/turizmi në këtë 6-mujor të parë kanë shënuar një rritje shumë e ndjeshme krahasuar me vitin paraardhës. Të ardhurat neto janë rritur 3 herëmë shumë krahasuar me 2020. Rritja e të ardhurave neto është më e lartë s dhe viti 2019, pasi vihet re që janë ulur shpenzimet gjatë këtij viti krahasuar me vitet paraardhëse.



Grafik 2: Të ardhurat neto nga udhëtimet/turizmi të 6-mujorit të parë, për vitet 2014 – 2021
(Burimi: Banka e Shqipërisë)

INVESTIMET E REJA NË FUSHËN E TURIZMIT

Duke qënë se turizmi u bë një nga fushat prioritare të zhvillimit ekonomik në vend kjo u pasqyrua dhe në rritjen e interesimit të bizneseve për të investuar në fushën e turizmit. Në vitet e fundit po vihej re një rritje e interesit të investimeve në fushën e turizmit, por periudha e mbylljes së aktiviteteve prej Covid-19, u ndje dhe në fushën e investimeve për ndërtimin e hoteleve dhe strukturave të tjera akomoduese. Më poshtë gjendet tabela që tregon vlerat e krahasuar të gjashtmuorit të parë për katër vitet e fundit:

Gjashtmuori i I 2017-2019	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i lejeve të ndërtimit për hotele e struktura të ngjashme	17	32	39	9	11
Vlera e përafërt e investuar (000 lekë)	998,862	1,428,758	11,068,368	383,362	35,758
Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar (m2)	29,023	42,896	310,962	11,259	5,964

Tab 1: Burimi INSTAT


SHPENZIMET DITORE DHE NETËQËNDRIMET

Një faktor i rëndësishëm në llogaritjen e të ardhurave që sjell turizmi në vend është dhe llogaritja e netëqëndrimeve për vizitorët e huaj, që shpenzojnë 1 natë e më shumë në Shqipëri, si dhe shpenzimet mesatare ditore që të huajtë (jo rezidentë) shpenzojnë në Shqipëri.

Përsa i përket **shpenzimeve mesatare ditore** për 6 mujorin e parë të 2021 për shtetasit e huaj jorezidentë që vizitojnë Shqipërinë për qëllime biznesi mesatarja ditore është 101.5 Euro që llogaritet 19,5 euro më pak në ditë krahasuar me të njëjtën kategori të një viti më parë. Ndërsa shtetasit e huaj që kanë qëndruar në Shqipëri për arsye personale kanë harxhuar një mesatare ditore prej 57,5 euro në ditë vlerë kjo që është 6 Euro në ditë më shumë se mesatarja ditore e shpenzuar për arsye personale në të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Përsa i përket **kohëqëndrimit mesatar për jorezidentët**, shifrat tregojnë se vizitorët e huaj që vijnë për qëllime personale gjatë periudhës gjashtëmujore të 2020 kanë një mesatare prej 4 netëqëndrimi. Ndërsa jorezidentët që kanë deklaruar si qëllim të vizitës së tyre në Shqipëri, arsye biznesi kanë pasur një mesatare prej 5.5 netë. Në të dyja rastet si për rezidentët që kanë si qëllim personal si ata për qëllim biznesi ka pasur një ulje në krahasuar me mesataren e netëqëndrimeve të të njëjtës periudhe të një viti më parë. Ulja për netëqëndrimet për arsye personale është 1 natë, ndërsa për arsye biznesi është 0,5 netë.

Numri i netëqëndrimeve të jorezidentëve, për gjashtë mujorin e parë të 2021 kemi rritje të ndjeshme të netëqëndrimeve krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020. Më poshtë jepet tabela krahasuese e netëqëndrimeve për gjashtëmujorët e para që nga viti 2014-2019.



Grafik 3: Netëqëndrimet e gjatëmuorëve të parë nga viti 2014-2020 (Banka e Shqiperise)

STRUKTURAT E REJA AKOMODUESE

Në lidhje me strukturat akomoduese gjatë periudhës Janar - Qershor 2021 janë regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim Taksave 243 struktura të reja akomoduese. Numri më i madh i strukturave të reja i takojnë bashkisë së Sarandës, bashki që zë 21,4 % të strukturave të reja në total, më pas vjen bashkia e Vlorës për numrin e madh të strukturave të regjistruara në gjashtëmujorin e parë të 2021 e më pas Tirana e Shkodra.

Më poshtë po japim një tabelë me totalin e strukturave të reja të strukturave të regjistruara krahasuar me gjashtëmujorin e parë të 2020:

RRETHET	NR. STRUKTURA TE REJA Janar –Qershor 2020	NR. STRUKTURA TE REJA Janar –Qershor 2021
Sarande	26	52
Vlora	25	49
Tirana	24	32
Lezhe	12	23
Durres	8	23
Shkodra	11	26
Korca	10	9
Diber	3	5
Fier	4	5
Gjirokaster	6	7
Elbasan	2	5
Kukes	1	3
Berat	2	4
TOTALI	134	243

Tab 2: Burimi I të dhënave Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave